



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2, dhe Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 12, paragrafi 1.18 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Dispozitat e Nenit 5, paragrafi 4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 15.07.2014 për aprovim të dokumentit "Procedurat për Kycje në Rrjetin e Transmisionit";

në seancën e mbajtur me datë 21 nëntor 2014, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** dokumenti "Procedurat për Kycje në Rrjetin e Transmisionit" të KOSTT Sh.a.

Arsyetim


- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 15.07.2014 ka pranuar kërkesën KOSTT Sh.a. për aprovim të dokumentit "Procedurat për Kycje në Rrjetin e Transmisionit".
 - o Dokumenti Procedurat për Kycje në Rrjetin e Transmisionit është përgatitur duke u bazuar në dokumentin Metodologjia e Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmisionit.
 - o ZRRE ka analizuar dokumentin dhe ka dhënë komentet e veta në dokument.
 - o Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT ka dërguar versionin final të dokumentit me datë 17.11.2014. Pas kësaj, ZRRE ka vlerësuar se dokumenti i dërguar "Procedurat për Kycje në Rrjetin e Transmisionit" i përmbush kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT-it.





Këshillë juridike: Palët e pakënaqura me këtë Vendim mund të iniciojnë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti "Procedurat për Kycje në Rrjetin e Transmisionit"

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar